



Skenderbeu e ka nisur me ritëm kampionesh në Korce. Përballe Besës, skuadra e Josës ka marrë një fitore minimale me rezultatin 1-0. Gjergji Muzaka ka gjetur golin që në minutën e 2' dhe me pas gjërat nuk kanë ndryshuar. Ndeshja është karakterizuar nga tensione midis lojtarëve gjë e cila ka sjellë tre kartona të kuq. Është ndeshuar Oreleshi për Skenderbeun dhe Poci bashkë me Berishën për Besën. Tre piket që i duheshin kampionet i mënyrës dhe tani do të sterviten të qetë për takimin e radhës që do të luajne në Vlorë ndaj Flamurtarit, një ndeshje tepër delikate. Përpara se të niste ndeshja, drejtues të FSHF-së kanë organizuar në Korce ceremoninë hapëse për Kategorinë Superiore, sezonin 2013-2014.